VENDIM
Nr. 526, datë 11.9.2018

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË DISA BASHKI, PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi për investime për funksionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, i miratuar në buxhetin e vitit 2018, në shumën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, shpërndahet për blerje automjetesh zjarrfikëse për bashkitë, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondet e mbetura pas përfundimit të procedurave të prokurimit rishpërndahen për bashkitë e tjera, me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela nr. 1

SHPËRNDARJA E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR BLERJE TË AUTOMJETEVE ZJARRFIKËSE PËR STACIONET E SHËRBIMIT ZJARRFIKËS TË 13 BASHKIVE

Nr.	Njësia e vetëqeverisjes vendore	Emërtimi i investimit	Vlera në lekë
1	Bashkia **Maliq**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 840 000
2	Bashkia **Konispol**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 840 000
3	Bashkia **Libohovë**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 840 000
4	Bashkia **Patos**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 840 000
5	Bashkia **Selenicë**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 840 000
6	Bashkia **Cërrik**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
7	Bashkia **Memaliaj**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
8	Bashkia **Sarandë**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
9	Bashkia **Rrogozhinë**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
10	Bashkia **Mallakastër**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
11	Bashkia **Klos**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
12	Bashkia **Vau i Dejës**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
13	Bashkia **Belsh**	Blerje, automjet zjarrfikës	3 850 000
	TOTALI		**50 000 000 lekë**